



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI



Nr. 197/6 prot

Koplik më: 10 /08/2020

**V E N D I M**

*Nr 47 datë 30 / 07 / 2020*

**PËR**

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të znj. Lize Delaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e kësaj shtetase nga buxheti i Bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

**Baza Ligjore**

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Me 18 vota pro:

**Vendosi;**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetases Lize Delaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e shtëpisë.

3. T’i akordojë familjes së shtetases Lize Delaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe i vitit 2020.

4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetases Liza Delaj, objekti shtëpi banimi e të ciles është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t’i propozojë/kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e Bashkisë.

5. Ndhimja financiare për familjen e shtetases Liza Delaj, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndhimja financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetases **Liza Delaj**, objekti shtëpi banimi e të ciles është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 784.100 (shtateqind e tetedhjetë e kater mije e njeqind ) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 4.485.047 (kater milion e katerqind e tetedhjetë e pese mije e dyzet e shtate ) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 5.269.147 (pese milion e dyqind e gjashtedhjetë e nente mije e njeqind e dyzet e shtate) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

9.U miratua më datë 30/07/2020.

10.U shpall me datë 08/08/2020.

**SEKRETAR I KESHILLIT**

**Emirjan Hasmujaj**



**KRYETARI I KESHILLIT**

**Ilir Halaj**